



“O Allah, unë kërkoj prej Teje udhëzimin, devotshmërinë, dëlirësinë dhe vetëmjaftueshmërinë!”

Abdullah ibn Mesudi (Allahu goftë i kënaqur me të!) tregon se Profeti ﷺ thoshte: “O Allah, unë kërkoj prej Teje udhëzimin, devotshmërinë, dëlirësinë dhe vetëmjaftueshmërinë!”

[Sahih] [Transmeton Muslimi]

Ndër lutjet e Profetit ﷺ ishte: “O Allah, unë kërkoj prej Teje udhëzimin”, domethënë rrugën e drejtë për ta njohur të vërtetën dhe për ta jetësuar. “Devotshmërinë”, domethënë përmbajtjen ndaj urdhrave dhe shmangien nga ndalesat. “Dëlirësinë”, domethënë largimin nga ajo që është e ndaluar ose e papërshtatshme, goftë në fjalë apo vepra. “Dhe vetëmjaftueshmërinë”, domethënë të qenët i pavarur nga nevoja për të tjerët dhe të mos ketë nevojë për askënd përveç Zotit të tij të Lartësuar.

<https://sunnah.global/hadeeth/sq/show/3596>

النجاة الخيرية
ALNAJAT CHARITY

